



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr. 2018 Prot

Gramsh, më 03.06.2021

U R D H Ë R

Nr. 142, datë 03.06.2021

PËR

MENAXHIMIN DHE KOORDINIMIN E RISKUT NË BASHKINË GRAMSH

Bazuar në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 10, 11 dhe 27 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, si dhe në rolin e Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut për bashkinë Gramsh:

URDHËROJ:

1. Delegimin e disa detyrave të Koordinatorit të Riskut të Bashkisë tek Z.Afrim Shtylla me pozicion Drejtor i Drejtorisë të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar si më poshtë vijon:
 - a) Bashkërendimin e veprimeve që lidhen me gjithë procesin e koordinimit të procesit për menaxhimin e risqeve;
 - b) Përgatitjen e kalendarit për procesin e menaxhimit të risqeve të bashkisë (përfshi njësitë vartëse);
 - c) Nëse e gjykon të arësyeshme, përgatitjen e urdhreve për ngritjen e ekipeve specifike për menaxhimin e risqeve strategjike me drejtues ose përfaqësues nga çdo strukturë e Bashkisë;
 - d) Organizimin e procesit të punës për zbatimin e kalendarit sipas afateve që vendosen për menaxhimin e riskut;
 - e) Konsolidimin e planeve të menaxhimit të risqeve të gjithë strukturave të bashkisë dhe përgatitjen e një raporti për Kryetarin lidhur me risqet me nivel të lartë që kërkojnë vëmendje të veçantë nga Kryetari ose nuk mund të menaxhohen tërsisht nga vetë drejtuesit funksionalë të bashkisë (përfshi njësitë vartëse). Raporti më pas shtrohet për diskutim dhe vendimarrje në Grupin e Menaxhimit Strategjik.
 - f) Raporton tek Koordinatori i Riskut të bashkisë për problematikën që del gjatë monitorimit ecurisë së menaxhimit të risqeve, veçanërisht për risqet me ndikim të madh në realizimin e objektivave vjetore dhe afatgjata të bashkisë me qëllim marrjen e masave urgjente për zbutjen ose eliminimin e ndikimit të tyre.

Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk cënon të drejtat e Nëpunësit Autorizues dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e detyrave përkatëse.

2. Anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik të bashkisë janë përgjegjës sipas nenit 11 të Ligjit 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për identifikimin dhe krijimin e regjistrat të risqeve, vlerësimin, kontrollin dhe raportimin për risqet që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.
3. Për koordinimin e punës lidhur me identifikimin e risqeve operacionale dhe të proceseve dhe hartimin e raporteve të menaxhimit të risqeve krijuhet ekipi i koordinatoreve për menaxhimin e risqeve, i kryesuar nga Koordinatori i Deleguar i Riskut me përfaqësues nga çdo strukturë funksionale e Bashkisë si më poshtë:
 - i- Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar
 - ii- Drejtoria e Shërbimeve me sipërmarrje, transporteve, strehim dhe emergjencave civile
 - iii- Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore
 - iv- Drejtoria e Infrastrukturës Rrugore
 - v- Drejtoria e Burimeve Njerëzore
 - vi- Drejtoria Juridike
 - vii- Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit
 - viii- Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sportit
 - ix- Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
 - x- Njësitë Administrative (Pishaj, Kodovjat, Poroçan, Sult, Skënderbegas, Lenie, Tunjë, Kukur, Kushovë)
4. Anëtarët e ekipit të koordinatoreve për menaxhimin e risqeve mund te jene drejtues të nivelit të mesëm, të ulët ose specialistë të bashkisë. Ata janë në vartësi administrative, veprojnë në emër dhe për llogari të drejtuesve të lartë të bashkisë që janë anëtarë të grupit te menaxhimit strategjik dhe/ose drejtues të njësive të varësisë.
5. Përgjegjësitë e detajuara të çdo niveli në fushën e menaxhimit të riskut janë si më poshtë:
 - a. Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) është përgjegjës për:
 - i. Diskutimin dhe miratimin e planeve strategjike (ose afatgjatë) të menaxhimit të riskut;
 - ii. Sigurimin e një menaxhimi efektiv të riskut në të gjithë strukturat dhe njësitë vartëse të bashkisë;
 - iii. Krijimin e kushteve për komunikim efektiv në lidhje me risqet midis të gjitha palëve të interesuara;
 - iv. Miratimin e planit të veprimit për reagimin ndaj risqeve, bazuar në informacionin e raportit të menaxhimit të risqeve të paraqitur nga Koordinatori i Riskut dhe/ose anëtarëve të GMS;
 - v. Sigurimin se planet e menaxhimit të risqeve (si pjesë të regjistrat të riskut) për programe/objektiva specifik rishikohen jo më pak se dy herë në vit.
 - b. Auditimi i Brendshëm është përgjegjës për:
 - i. Vlerësimin e sistemit të Menaxhimit të Riskut në Bashki (përfshi dhe njësitë vartëse);

- ii. Sigurimin e efektivitetit të mekanizmave të kontrollit, të vërë në dukje risqet, ose ngjarjet e padëshirueshme që mund të ndodhin si rezultat i mekanizmave të kontrollit të papërshtatshëm ose jo efektiv dhe të japë rekomandime që synojnë forcimin e tyre.
 - c. Drejtuesit funksionalë të lartë dhe të mesëm të bashkisë janë përgjegjës sipas nivelit hierarkik për:
 - i. Përcaktimin e objektivave të strukturës që mbulojnë;
 - ii. Identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që mund të pengojnë arritjen e objektivave vjetore dhe afatmesme;
 - iii. Pranimin e nivelit të risqeve që mund të minimizojnë sipas shkallës së përgjegjësisë dhe adresimin e risqeve të larta në GMS për vendimarrje të mëtejshme;
 - iv. Përcaktimin e mënyrës së reagimit ndaj risqeve dhe masave për kontrollin apo minimizimin e tyre;
 - v. Përgatitjen e planit të masave dhe afatet e raportimit për aktivitetet që ndërmerrën për minimizimin e risqeve;
 - vi. Për risqet që janë vlerësuar të larta kahas planit të masave duhet të përgatitet dhe një raport argumentues për grupin e menaxhimit strategjik;
 - vii. Monitorimin dhe përditësimin në vazhdimesi të planeve për minimizimin e çdo risku;
 - viii. Të sigurojnë se të gjithë punonjësit janë të njojur me procesin e hartimit dhe monitorimit të planeve të menaxhimit të riskut, të cilat në tërësinë ë tyre formojnë rregjistrin e riskut të strukturës përkatëse.
 - ix. Inkurajimin e kulturës së Menaxhimit të Riskut në të gjithë nivelet.
6. Koordinatoret e riskut, të caktuar sipas pikave 3 dhe 4, konsiderohen ndihmësit kryesorë të drejtuesve të lartë për realizimin e detyrave të këtyre të fundit në kuadrin e përgjegjësive në pikën 5 (c) të këtij urdhëri. Kryerja e detyrave nga ana e koordinatorit të riskut nuk e shkarkon drejtuesin e tij sipas pikes 5(c) nga përgjegjësia administrative për realizimin e detyrave përkatëse.
7. Afatet e kryerjes së aktiviteteve
- a) Regjistri i risqeve për çdo strukturë është tërësia e planeve të menaxhimit të çdo risku të identifikuar në strukturën përkatëse (sipas formatit në aneksin bashkëlidhur) dhe duhet të hartoher ose përditësohet brenda tre mujorit të parë të cdo viti duke u bazuar në objektivat dhe planet operacionale të punës së çdo strukture.
 - b) Brenda muajit Maj të cdo viti të jetë konsoliduar regjistri i risqeve dhe të përgatitet raporti për grupin e menaxhimit strategjik. Diskutimi i risqeve kryesore duhet të trajtohet në GMS në të njëjtën kohë me përgatitjen e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm (PBA) të bashkisë.
 - c) Në 10 ditëshin e parë të muajit Shtator të cdo viti, mblidhet grapi i menaxhimit strategjik për analizimin, vlerësimin dhe miratimin e planit të veprimit për menaxhimin e risqeve me nivel të lartë. Si rregull miratimi/rishikimi i planeve të menaxhimit të risqeve me masat dhe afatet e raportimit duhet të finalizohen në të njëjtën kohë me miratimin e dokumentit përfundimtar të buxhetit afatmesëm të bashkisë.
 - d) Në vijim të miratimit të planeve të menaxhimit të risqeve, ekipi i koordinatorëve të riskut organizon punën brenda strukturave përkatëse për monitorimin e aktiviteteve për minimizimin e

risqeve dhe raporton, sipas afateve të paracaktuara, tek drejtuesi i lartë përkatës i strukturës dhe tek Koordinatori i deleguar i riskut për bashkinë.

- e) Koordinatori i Deleguar i Riskut raporton rregullisht tek Kryetari i Bashkisë për procesin e menaxhimit të risqeve prioritare.
 - f) Anëtarët e grupit të menaxhimit strategjik diskutojnë rregullisht në mbledhjet mbi problematikat që hasen gjatë procesit dhe korrigimin e masave përkatëse nëse është e nevojshme dhe brënda shkallës së përgjegjësisë së tyre.
 - g) Në rastet e masave për minimizim të risqeve që tejkalojnë kompetencat e kryetarit të bashkisë, cështjet shtrohen për vendimarrje në këshillin bashkiak sipas kalendarit të miratimit, rishikimit apo raportimin mbi zbatimin e buxhetit vjetor.
8. Ngarkohen anëtarët e grupit të menaxhimit strategjik për caktimin nominal të koordinatorëve të riskut për strukturat që mbulojnë. Njoftimet dergohen zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike tek koordinatori i deleguar i riskut për bashkinë.
9. Ngarkohen të gjitha strukturat përfshi edhe njësitë vartëse të bashkisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË



Konceptoi: K.Xheka
Pranoi: A.Shtylla
Miratoi: A.Shuli
Konfirmoi:
Dosja nr.
Afati i ruajtjes

[Handwritten signature over the text]

ANEKS: PLANI I MENAXHIMIT TE RISKUT

	Numri i References së Riskut	<i>Numri serial i riskut</i>
IDENTIFIKIMI I RISKUT	KATEGORIA E RISKUT	<i>Strategjik, Rregulator, Sistemet Operacionale, Financiar, Menaxherial, i Jashtëm</i>
	PROCES / NENPROCES	<i>Emërtimi i nënprocesit</i>
	OBJEKTIVI	<i>Cilin objektiv prek ngjarja e riskut?</i>
	NGJARJA E RISKUT	<i>Përshkrimi i riskut, mundësia e ndodhjes se tij apo e ndikimit që do të përpinqemi të zvogëlojnë. (Risqet janë ngjarje të mundhshme të ardhme që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave.</i>
	SHKAKU I RISKUT	<i>Cilat janë rrethanat, shkaktarët që vetëm apo marra bashkë rrisin mundësinë e ndodhjes së riskut? Mund të janë disa shkaqe.</i>
	NDIKIMI / PASOJA	<i>Nëse risku ndodh si do të ndikojë tek objektivi? Cilat janë pasojat në nivel afatgjatë?</i>
ANALIZA E RISKUT	MASAT EKZISTUESE TE KONTROLLIT	<i>Çfarë bëhet tani për të zvogëluar mundësinë apo pasojën e ndodhjes?</i>
	Mundësia (1-5)	<i>Sa mundet të ndodhë? (Vlereso nga 1-e ulët deri në 5 – shumë e lartë)</i>
	Pasoja (1-5)	<i>Sa e rëndë? (Vlereso nga 1-e ulët deri në 5 – shumë e lartë)</i>
	Rezultati	<i>Result (M x P)</i>
VLERESIMI	Prioriteti i Riskut	<i>Ekstrem, I lartë, I mesëm, I ulët</i>
	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	<i>Mungojnë, Jo të përshtatshme, Të përshtatshme, Të forta, Të tepruara</i>
	REAGIMI NDAJ RISKUT	<i>Do ta zvogëloni, monitoroni, transferoni apo shhangni riskun?</i>
MASAT PER TRAJTIMIN / ZVOGELIMINI E RISKUT	MASAT SHTESE PER TRAJTIMIN E RISKUT	<i>Çfarë do të bëni për ta menaxhuar më mirë riskun?</i>
	FORMA E MASAVE	<i>Çfarë forme do të marrë ky trajtim? P.sh Plan veprimi, plan projekti, raportim, ndryshim ligjor etj.</i>

BURIMET E KERKUARA	<i>Çfarë kërkohet për tu zhvilluar dhe zbatuar masa e propozuar?</i>
PRONARI I RISKUT	<i>Kush do të drejtojë punën për trajtimin e risikut?</i>
SHPESHTESIA E RAPORTIMIT	<i>Cilat jane periudhat/ datat e raportimit mbi progresin e arritur dhe problematikat?</i>
DATA E PERFUNDIMIT	<i>Kur do përfundojë masa e propozuar?</i>
LIDHJA ME STRUKTURA / INSTITUCIONE TE TJERA	<i>A lidhet ngjarja apo trajtimi i riskut me ndonjë strukturë apo institucion tjeter? A ka pasojë tek ndonjë institucion tjeter?</i>
GJENDJA E RISKUT PAS MARRJES SE MASAVE	Niveli i Riskut të synuar pas zbatimit të masave (I Lartë, I mesëm, I ulët)